VENDIM
Nr. 177, datë 26.3.2014

PËR KRIJIMIN, PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN, PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT E KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR ADMINISTRIMIN E UJËRAVE NDËRKUFITARE

(Ndryshuar me VKM nr. 223, datë 11.3.2015)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 22, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Komisionit të Posaçëm për Administrimin e Ujërave Ndërkufitare.

2. Komisioni kryesohet nga *zëvendësministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave*, përgjegjës për fushën e ujërave, dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

- Ministria e Punëve të Jashtme;
- Ministria e Drejtësisë;
-Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
-Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
- Ministria e Energjisë dhe Industrisë;
- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës;
- Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit;
- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Shëndetësisë;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Ministria e Kulturës;
- Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë;
- *ministri i Shtetit për Çështjet Vendore;*
- *Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit.*

3. *Drejtoria përgjegjëse për administrimin e ujërave, në ministrinë përgjegjëse për fushën e ujërave* asiston në çdo mbledhje të Komisionit dhe ka për detyrë:

a) hartimin e programit të mbledhjes;

b) hartimin e drafteve sipas tematikave përkatëse;

c) njoftimin e anëtarëve;

ç) realizimin e detyrave të tjera që i ngarkon kryetari i Komisionit.

4. Ngarkohen titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 2 për të caktuar përfaqësuesit e tyre në këtë Komision, të cilët duhet të jenë të niveleve të larta drejtuese.

5. Komisioni harton, shqyrton dhe i propozon *ministrit përgjegjës për fushën e ujërave* marrëveshje bashkëpunimi me secilin vend fqinj, duke trajtuar të gjitha çështjet që lidhen me menaxhimin e integruar të burimeve ujore ndërmjet vendeve respektive.

6. Për probleme dhe çështje specifike, Komisioni ka të drejtën të krijojë nënkomisione me ekspertë të fushave përkatëse.

7. Veprimtaria e Komisionit mbështetet në legjislacionin shqiptar, si dhe në marrëveshjet e konventat ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

8. Vendimi nr. 337, datë 15.7.1999 i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Komisionit Qeveritar për Problemet Ujore me Vendet Fqinje", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama